



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 676/1607(31010-00462-83-2015)  
Dt. Rregj. 28.10.2015

Nr. Vendimi 273(208)  
Dt. Vendimi 15.04.2016

**V E N D I M**  
**"NE EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

**Valbona DURRAJ – gjyqtare**

Asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me datë 15.04.2016, ora 10.30 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr.Rregj.Them. 676/1607(31010-00462-83-2015) datë 28.10.2015 me pale ndergjyqese:

**PADITËS:** Tatimpaguesi "Hasbije Gjuhca" identifikuar me NIPT L06727001D, me seli në Zues, pranë Urës së Bunës..

**TE PADITUR:** 1-Drejtorja Rajonale e Tatimore Shkodër, perfaqsuar nga znj. Siriana Bakushi  
2-Drejtorja e Apelimit Tatimor-pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë perfaqsuar nga znj. Siriana Bakushi

**Me pjesmarrje te:** Avokaturës së shtetit( në mungesë)


**OBJEKTI:** Shfuqizimi i aktit, njoftim vleresimi per detyrimet tatimore nr.6933 prot date 17.08.2015 i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder dhe shfuqizim i vendimit nr.25314/I date 30.09.2015 i Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.

**BAZA LIGJORE:** Neni 17/a,7/a,15/a të Ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative, neni 31,32 e vijues i K.Pr.Civile , neni 109 i Ligjit Nr9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R.Sh-se"i ndryshuar, udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura, dhe pasi dëgjoi palën paditëse që kërkoi përfundimisht pranimin e kerkese padisë sipas objektit te saj, përfaqesuesen e palëve të paditura znj.Siriana Bakushi, e cila u shpreh për rrëzimin e kërkeve padisë si të pambështetur në ligj dhe prova,në mungesë të Avokaturës së Shtetit, shqyrtoi dhe analizoi çështjen

## VËREN se

Paditesia Hasbije Gjuhca, i eshte drejtuar Gjykates Administrative Shkalle e Pare Shkoder, me kerkese padi kunder anes se paditur Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane, Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder, me objekt : Shfuqizimi i aktit, njoftim vleresimi per detyrimet tatimore nr.6933 prot date 17.08.2015, Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder dhe shfuqizim i vendimit nr.25314/1, date 30.09.2015 i Drejtorise se Apelit Tatimor Tirane.



### ***Rrethanat e ceshtjes;***

Drejtorja Rajonale e Tatimeve Shkoder ka njoftuar subjektin me detyrime vleresuar sipas njoftim-vleresimit nr.6933 prot date 17.08.2015: denim per "mosleshim te kuponit tatimor", gjate ofrimit te sherbimit me vleren totale 499.000 leke.

Grupi i punes se Kontrollit Tatimor, prane Drejtorise Rajonale Tatimeve Shkoder ne baze te Urthrit te punes nr.443/3 prot date 02.03.2013, ka ushtruar kontroll ne ambientet e ushtrimit te aktivitetit te subjektit Hasbije Gjuhca, me numer Nipti L06727001D, ne adresen "Ura e Bunes", Shkoder dhe ka mbajtur Akt konstatimin me numer serie 0487052 date 02.08.2015.

Ne Akt konstatim numer serie 0487052 date 02.08.2015, eshte pasqyruar fakti ne momentin e kontrollit. Ku nder te tjera thuhej :

1. *Ne momentin e kontrollit u gjenden ne pune 1) Dorjan Culiq 2. Gledis Bashi etj...*
2. *Subjekti kishte te instaluar dhe perdor kassen fiskale me nr.BN 03001177, EN 06012616, EN 06012534.*
3. *Nuk kishte raste mosmarrje te kuponit tatimor nga bleresi.*
4. *U verifikua saktesia e leshimit te kuponit tatimor dhe u gjeten 2, (dy) raste te mosleshimit te kuponit tatimor.*
5. *Ka te afishuar posterin per leshimin e kuponit tatimor .*
6. *etj.*

Rezulton qe akti te jete nenshkruar nga subjekti.

Ne vijim nga grupi i kontrollit tatimor eshte mbajtur Procesverbali i gjobes me numer serie 0191252 date 02.08.2015, sipas te cilit subjekti eshte sanksionuar me gjobe per "mos leshim te kuponit tatimor", gjate ushtrimit te aktivitetit te tij ne ofrimin e sherbimit, bazuar ne nenin 122, pika 1, germa (b; i) te Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne RSH-se" i ndryshuar.

Subjekti duke mos qene dakort ka apeluar ketë masë të ndërmarrë ndaj tij dhe Apeliti tatimore me vendimin nr 25314/1 dt 30.09.2015 ka vendosur lenien ne fuqi te njoftim vleresimit tatimore te mesiperm.

### ***Ne gjykim paditesi prashtroi se;***

Ne momentin e kontrollit ne kami patur te leshuar te gjithë kuponat tatime dhe fakti qe permendet ne akt konstatim, qe dy tavolina nuk kishin kupon tatimore, nuk qendron, pasi tavolinat jane ne ambientet e jashtme te lokalit, dhe mundesia per te mos u gjetur ne tavoline per shkak te eres, ekziston, per kete arsye i kemi kerkuar grupit te kontrollit qe te terheqe te dhenat e kases ne ate moment dhe nuk e ka bere, kete fakt e pohojne dhe te dy inspektorët te paraqitur ne gjykim nga vete ana e paditur, duke konfirmuar keshtu faktin qe nuk ka kryer veprimin e terheqjes nga kasa te kuponit tatimore qe rregjistrohet ne kase, me pretendimin qe nuk e kane pare te arsyeshme.

Per pazoje kerkojne pranimin e kerkese padise sipas objektit.

**Ana paditur parashtroi se:**

Ligji nr.9920/2008 neni 122 I tij (referuar bazes ligjore ne fuqi ne periudhen e konstatimit), ka percaktuar:

Tatimpaguesi, person juridik ose fizik tregtar denohet ne rast se :

b) *Nuk leshon kupon tatimor per te dokumentuar qarkullimin e realizuar te mallrave apo te sherbimeve,*

ii) *Per cdo konstatim (verifikim) te kryer, me gjobe ne masen 200 000 (dyqind mijë leke per tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi fitimin dhe gjobe ne masen 50 000 (pesedhjete mijë) leke per tatimpaguesit e tjere .*

Nga akt konstatimi rezulton se dy tavolina ishtin pa kupon tatimore dhe per kete ne respektim te ligjit eshte vendosur masa e gjobes, sipas proces-verbal gjobe me numer serie 0191252 date 02.08.2015, ne masen 400.000 leke.

**Gjykata vlereson se :**

Detyrimi per te instaluar dhe perdorur paisjen fiskale, percaktohet ne Ligjin 9920, date 19.5.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh-se-", i ndryshuar, neni 54, 55 "Detyrimi per perdorimin e paisjeve fiskale", Udhezirnin m.24, date 02.09.2008:, i ndryshuar ne zbatim te tij, Kreu VI, pika 55, dhe Vendimin e KM nr.781, date 14.II. 2007, i ndryshuar, Udhezimi nr.16 date 03.05.2010 "Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te pajisjeve fiskale", i ndryshuar.

Ligji nr.9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, neni 54, pika 3 percakton se :

*"Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice, qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise apo njesi te perhershme te hapura per publikun, duhet te instalojne pajisje fiskale dhe te leshojne kupona tatimore per cdo transakcion".*

**neni 55**

Detyrimi per perdorimin e pajisjeve fiskale" shpreh :

1. *"Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor.*

4. *Ministri i Financave, me udhezimin, miraton proceduren dhe dokumentacionin per miratimin per perdorim te pajisjeve fiskale, elementet e kuponit tatimor, menyren e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancen e ruajtjes se kuponit tatimor dhe rregullat per mirembajtjen e tyre teknike e te sherbimit .*

Ne Udhezimin nr.24 date 02.09 .2008 "Per procedurat tatimore", ndryshuar,

"Detyrimi per perdorimin e Pajisjeve fiskale", pika 55 shprehet :

*Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin dhe personat e tatueshem, tatimpagues i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel" Jane te detyruar te pajisen, te perdorin dhe mirembajne pajisjet fiskale ne perputhje me dispozitat e Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 781, date 14. 11.2007 "Per karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per transferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per*

pajisjen me autorizim te shoqerive te autorizuar per ofrimin e pajisjeve fiskale" dhe ato te tjera nenligjore ne zbatim te tij.

Ne nenm 46 te ligjit nr.9920 dt.19 .05 .2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar eshte parashikuar detyrimi i tatimpaguesit per te leshuar fatura tatimore, deftesa tatimore ose kupon tatimor.

VKM nr. 781 date 14. 11.2007, percakton se: "te gjitha tatimpaguesit e shitjeve me pakice, qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise apo njesi te perhershme te hapura per publikun, instalojne pajisje fiskale dhe leshojne kupone tatimore per cdo transakcion".

Referuar rrethanave te faktit ana e paditur nuk arriti te provoje faktin e pershkruar ne akt konstatimin, pasi nuk kishte bere kontrollin fizik te kuponave te leshuar nga kasa. ne mometin e konstatimit te pretenduar qe dy tavolinave nuk i eshte gjetur kuponi tatimor, dhe se nga ana tjeter, ne pershkrimin e bere ne akt konstatim ka kunderthenie mes pikes 3 dhe 4, ku ne piken

3. Nuk kishte raste mosmarrje te kuponit tatimor nga bleresi, dhe

4. U verifikua saktezia e leshimit te kuponit tatimor dhe u gjeten 2, (dy) raste te moslesimit te kuponit tatimor.

Per pasoje, referuar neni 37 te Ligjit nr.49/2012 date 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykateve administrative dhe gjykimin e mos marreveshjeve administrative" pika 1 shpreh:

"Gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundërshtohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrative".

Gjykata konstaton se organi administativ DRT Shkoder nuk arriti te provoje ligjshmerine e aktit mbi baze prove, pra te permbushe detyrimin ligjore sipas ligjit 9920/2008 dhe atij 49/2012, e se ne keto kushte gjykata vendose pranimin e kerkese padise sipas objektit dhe meqenese vlere e aktit qe kundërshtohet është me vogël se njëzet fishi i pagës minimale në shkallë vendi, konform nenit 45 pika b të ligjit 49/2012, ky vendim është i formës së prerë, prandaj

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40,41,42 dhe 45 pika b të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" nenit 126, 306 dh 310 të K.Pr.Civile

### VENDOSI

-Pranimin e kërkesë padisë.

-Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.38/31 prot datë 06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi me shkresën nr.2172/1 prot datë 19.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë

-Shpenzimet gjyqesore (në vlerën e taksës së padisë 3000 lekë) në ngarkim të palës së paditur.


-Ky vendim është i formës së prerë,perben titull ekzekutiv dhe ekzekutohet ne mënyre te menjëhershme.

-Kunder vendimit nuk lejohet ankim.

-Shkoder me date 15.04.2016

**SEKRETARE SEANCE**

**Borana LITI**



**GJYQTARE**  
**Valbona DURRAJ**

